



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.910/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Shaip Morina kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Shaip Morina kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, në Vendvotimet: 0812C/01R, 0812C/02D , 0816C/01R, 0807C/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.910/2017 me datën 10.11.2017, e parashtruar nga Shaip Morina kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se pas rezultateve përfundimtare të KQZ-së ka poseduar 200 vota, mirëpo pas rezultateve preliminare të publikuara nga KQZ, ka poseduar 212 vota, andaj në bazë të krahasimit të të dhënave të rezultateve përfundimtare dhe preliminare, ka identifikuar këto mos përputhje: në vendvotimin 0807c/01R pas rezultateve përfundimtare ka poseduar 8 vota, ndërsa pas rezultateve preliminare ka poseduar 15 vota, në vendvotimin 0812c/01R pas rezultateve përfundimtare ka poseduar 5 vota, ndërsa bazuar në formularin për përputhje të të dhënave ka poseduar 8 vota, në vendvotimin 0812C/02D, ka poseduar 8 vota ndërsa pas rezultatit përfundimtar vetëm 7 vota, në vendvotimin 0816C/01R ka poseduar një votë ndërsa pas rezultateve përfundimtare asnjë

votë. Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur formularët për përputhje të të dhënave dhe rezultateve si dhe tabelat e rezultateve përfundimtare të publikuar nga KQZ.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të bazuara për faktin se pas shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Paneli në mbështetje të nenit 117.4 e urdhëron KQZ-n që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit të vendimit.

Prandaj, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura PZAP-i vendosi si në pjesën II të dispozitivit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.910/2017 më datën 12.11.2017.



Kryesues i Panelit
Zyheri Haxhi

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*